
e-Filing

Udhëzuesi i Përdoruesit Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale



Autorësia: ikubINFO

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
Hyrje në sistem	3
Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale	4
Krijimi i Deklaratës Vjetore i të Ardhurave Personale	4
Data e pritshme e dorëzimit të Deklaratës Vjetore e të Ardhurave Personale	7
Shfaqja e deklaratës dhe shkarkimi i Udhëzuesit, “Deklarata Vjetore e Të Ardhurave Personale	8
Plotësimi i rubrikave të deklaratës DVAPv3 dhe validimi sipas rregullave	9
SEKSIONI A: TË DHËNA IDENTIFIKUESE	9
SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT	10
TE ARDHURAT BRUTO	10
TË ARDHURAT E TJERA TË NDRYSHME NGA TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI	11
SHPENZIMET E ZBRITSHME	14
VLERA E TATUESHME DHE TATIMI PER TU PAGUAR	16
TATIMET E PAGUARA GJATË PERIUDHËS TATIMORE	18
LLOGARITJA E REZULTATIT	21
Ruajtja dhe dorëzimi	21
Krijimi i deklaratës model “Ndryshim nga individi”	23
Gjenerimi i urdhërpagesës	24

Hyrje

Ky manual shërben si udhëzues për të gjithë individët dhe/ose përfaqësuesit të cilët kanë të drejtë dhe/ose detyrimin e dorëzimit të deklaratës elektronike vjetore të të ardhurave personale. Çdo individ i cili ka një rregjistrim të vlefshëm në rregjistrin e Administratës Tatimore identifikohet në mënyrë unike nëpërmjet NID në sistemin E-Filing po ashtu edhe në sistemin C@TS.

Hyrje në sistem

Çdo përdorues i cili ka një rregjistrim të vlefshëm, mund të aksesojë llogarinë e tij eFiling, nëpërmjet link https://efiling.tatime.gov.al/cats_public/Account/LogOn dhe do t'i shfaqet pamja sipas figurës së mëposhtme:




Hyrje në sistem

Përdoruesi plotëson kredencialet:

Emër përdoruesi: Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit i cili plotësohet sipas numrit që deklaruesi ka në dokumentin e letërnjoftim ID-së (në kartën e identitetit, pasaportë

Fjalëkalimi_ password i përcaktuar prej tij

Në mungesë të plotësimit të fushës së fjalëkalimit përdoruesi zgjedh të aksesojë llogarinë tij duke klikuar në link E-Albania Login 

Gjuha e përzgjedhur me një nga dy opsionet e shfaqura në listën e varur, Shqip ose Anglisht, mundëson shfaqjen e formave dhe të dhënave në sistem, sipas kërkesës së përdoruesit.

E detyrueshme: Me qëllim që të aksesojë llogarinë e tij, përdoruesi duhet të shënjojë kutizën **E lexova dhe bie dakord** me [termat dhe kushtet](#) e përdorimit.

Hyr në sistem

Me klikimin e Butoni , mundësohet aksesimi i të dhënave të llogarisë efilng.



Mirëseerdhët

Nëse tashmë jeni i regjistruar në efilng mund të hyni në sistem. Në të kundërt duhet të regjistroheni që të hyni në sistem.

Regjistro

Jeni një individ privat dhe doni të dorëzoni Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave Për Individët?

Ju lutemi, për një regjistrim të ri ose për hyrje për herë të parë në sistem [Regjistrohuni këtu](#)

Nëse nuk jeni nënshkruar Shqiptar, duhet të drejtoheni në zyrën më të afërt tatimore për tu regjistruar!

Hyr në sistem | E-Albania Login

Emri i Përdoruesit: A0000000B

Fjalëkalimi: *****

Gjuha: Shqip (sq-AL)

E lexova dhe bie dakord me [termat dhe kushtet](#)

Hyr në sistem

Hyrje në sistem


Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale

Nëpërmjet sistemit e-Filing individi i rregjistruar për përgjegjësinë tatimore të Tatimit mbi te Ardhurat Individuale, duke filluar nga viti 2025 deklaron dhe dorëzon Deklaratën Vjetore të të Ardhurave Personale me një model të ri deklarate DVAPv3.


Krijimi i Deklaratës Vjetore i të Ardhurave Personale

Deklarata e të Ardhurave Personale është deklarata me periodicitet deklarimi vjetor. Kjo deklarata u mundësohet individëve të cilët sipas dispozitave të ligjit 29/2023, janë të detyruar të deklarojnë dhe paguajnë tatimin mbi të ardhurat personale për të ardhurat e realizuara vjetore, pas regjistrimit për llojin e tatimit "Tatimi mbi te ardhurat individuale".

Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale, është e vlefshme për tu krijuar nga përdoruesi në menunë Deklarata, Tatim mbi të Ardhurat Personale dhe duke përzgjedhur tabelën "Deklarata të Padorëzuara".



Menuja Deklarata/ Tatim mbi të Ardhurat individuale




Nën menuja Deklarata të Padorëzuara

Nën menuja Deklarata të Padorëzuara shfaq të dhëna lidhur me:

- Periudha
- Data e krijimit
- Data e Pritshme e Deklaratës
- Detyrim i Deklaruar
- Kredia Tatimore
- Ndryshim
- Frekuenca e Dorëzimit


Për krijimin e deklaratës për një periudhë tatimore është e nevojshme shtypja e butonit

Krijoi Deklaratë




Butoni Krijoi Deklaratë


Pas shtypjes së butonit Krijoi Deklaratë në ndërfaqe shfaqet një dritare e cila përmban në një listë të varur periudhat e vlefshme vjetore për të cilën kërkohet krijimi i deklaratës si dhe butonin Krijoi



Përzgjedhja e periudhës dhe krijimi i deklaratës

Shënim: Përzgjedhja e njëres nga periudhat e varura në listë është e detyrueshme për krijimin e deklaratës.

Pas klikimit të butonit , deklarata krijohet me sukses dhe listohet në gridën e deklaratave të krijuara por të padorëzuara.



Deklarata e krijuar me status të padorëzuar

Data e pritshme e dorëzimit të Deklaratës Vjetore e të Ardhurave Personale

Deklarata vjetore e Tatimit mbi të Ardhurat Personale deklarohet në bazë vjetore, për të ardhurat dhe pagesat e rezultuara deri 31 dhjetor të vitit paraardhës duke filluar nga data 22 janar. Ajo ka për qëllim llogaritjen e rezultatit vjetor për tatimin e mbipaguar apo tatimin e detyruar për tu paguar për të ardhurat e realizuara vjetore të individit. Data në të cilën plotësohet dhe dorëzohet deklarata nga e-Filing e merr vlerën automatikisht nga sistemi në momentin që individi e dorëzon deklaratën, ndërkohë që data e pritshme e deklaratës është afati i saj ligjor për deklarim i përcaktuar në ligjin e tatimit mbi të ardhura, ku duke filluar nga periudha tatimore 24-A, është 31 mars e vitit pasardhës të periudhës raportuese.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE **E-Tax Shqipëri**

Deklarata | Kontabilitet | eFiling Im | Menaxhimi i Aksesit | Rreth eFiling

Deklarata: 1800, Tatimi mbi te ardhurat individuale

Deklarata

- Deklarata të Padorëzuara (1)
- Deklarata të Dorëzuara
- Deklarata të Refuzuara
- Deklarata të Arkivuara

Deklarata të Padorëzuara

Periodha: -

Data e krijimit: -

Ndryshim: ???

[Eksporto në Excel](#) | [Ringarko](#)

Periodha	Data e krijimit	Data e Pritshme e Deklaratës
2025 Janar-Dhjetor (25-A)	23.01.2026	31.03.2026


E para E Mëparshme 1 Pases E Fundit

Shfaqja e të dhënave

Data e krijimit dhe data e pritshme e dorëzimit të deklaratës

E rëndësishme: Cdo deklaratë e krijuar apo dorëzuar pas këtij afati gjeneron gjobën për deklarim të vonuar, pavarësisht rezultatit të saj. Gjopa gjenerohet në momentin e krijimit të deklaratës nga individ në cdo rast që data e krijimit është pas afatit edhe nëse kjo deklaratë ka status të krijuar por të padorëzuar.

Shfaqja e deklaratës dhe shkarkimi i Udhëzuesit, “Deklarata Vjetore e Të Ardhurave Personale

Në nën menunë Deklarata të Padorëzuara, shfaqet rekordi i deklaratës DVAPv3 me status krijuar, por e padorëzuar, bashkë me detajet e saj. Përdoruesi klikon mbi ikonën  për të kontrolluar, plotësuar apo dorëzuar deklaratën.

Pas klikimit të butonit, forma e shfaqur përmban rubrikat me emërtimet përkatëse ku disa prej të cilave do të jenë të pambushura nga informacioni i ndodhur në sistem, por të editueshme sipas rregullave dhe kontrolleve të implementuara të cilat do të detajohen në vijim.

Gjithashtu, përdoruesi ka të vlefshëm dhe dokumentin e Udhëzuesit të Deklaratës, i cili aksesohet dhe shkarkohet/printohet duke klikuar mbi link “[Shkarko Udhëzimet](#)”.



Detajet e deklaratës

Në fund të deklaratës përdoruesi mund të verifikojë saktësinë e të dhënave të plotësuara, të ruaj apo të dorëzojë deklaratën nëpërmjet butonave

Kontrollo saktësinë e formës

Ruaj

Dorëzo

- **Butoni “Kontrollo saktësinë e formës”** shërben për të validuar fushat e plotësuara nëse janë në përputhje me rregullat e validimit të implementuara në sistem për këtë deklaratë.
- **Butoni “Ruaj”** shërben për ruajtjen paraprake të deklaratës në status “Të padorëzuar” dhe individi do mund të kryejë ndryshime deri në klikimin e butonit “Dorëzo”.
- **Butoni “Dorëzo”** shërben për dorëzimin final të deklaratës. Kjo deklaratë ruhet në modelin “Normal”.

Plotësimi i rubrikave të deklaratës DVAPv3 dhe validimi sipas rregullave

Për çdo rubrikë të deklaratës zbatohen rregullat e kontrollit të saktësisë dhe të llogaritjes automatike. Disa fusha janë të parambushura, disa të vlefshme për plotësim nga individi, disa janë vetëm të lexueshme. Të gjitha fushat gri, llogariten automatikisht nga sistemi dhe nuk mund të ndryshohen nga përdoruesi. Fushat e parambushura apo dhe ato pa vlera plotësohen nga përdoruesi, por mbi këto fusha aplikohen disa rregulla validimi. Rubrikat që përmbajnë shenjën e asteriks “*”, janë të detyrueshme për plotësim, si psh: **(7) Adresa Kryesore: ***.

SEKSIONI A: TË DHËNA IDENTIFIKUESE

Sistemi shfaq mesazhet e gabimit në cdo rast që deklarata validohet apo dorëzohet pa l plotësuat të dhënat identifikuese të detyrueshme:

Mesazhe per gabime validimi.

- **Adresa Kryesore: duhet plotësuar**
- **Qyteti/Komuna/Rrethi: duhet plotësuar**
- **Specifikoni njëzën nga opsionet tek: Statusi i Deklaruesit**
- **Cel. duhet plotësuar**

Rubrika [18], **Femije nen moshen 18 vjec,**

është e detyrueshme për plotësim pasi ajo shërben për llogaritjen e zbritjeve tatimore që individi ka të drejtë të aplikojë sipas referencave ligjore.

Ajo duhet të plotësohet nga përdoruesi me vlerë =0 ose më të madhe se zero në varësi të numrit të fëmijëve nen moshen 18 vjec dhe në cdo rast që kjo rubrikë do të lihet bosh, deklarata nuk mund të dorëzohet dhe sistemi do të shfaq mesazhin: **Rubrika [18] është e detyrueshme për plotësim.**



Seksioni A_ TË DHËNA IDENTIFIKUESE

SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT

TE ARDHURAT BRUTO

Të ardhurat përfaqësohen nga rubrika 3 deri në rubrikën 23, të paraplotësuara apo të vlefshme për plotësim në cdo rast që individi ka të ardhura shtesë për të deklaruar, vlera e të cilave shfaqet më e vogël apo për to në deklaratë nuk ka parambushje automatike.

SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT

TË ARDHURAT BRUTO

	+
[3] Të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit	[3] 0
[4] Të ardhura bruto nga marrëdhëniet e ngjashme me punësimin por që nuk konsiderohen nga marrëdhëniet e punësimit	[4] 0
[5] Të ardhurat bruto nga dividendi	[5] 0
[6] Të ardhurat bruto nga qiraja	[6] 0
[7] Kthimi i investimit nga skemat e sigurimit të jetës dhe/ose pensionit privat	[7] 0
[8] Të ardhurat bruto nga interesat bankare	[8] 0
[9] Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj	[9] 0
[10] Fitimi kapital i tatueshëm i krijuar nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së luajtshme	[10] 0
[11] Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit	[11] 0
[12] Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licëna, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike	[12] 0
[13] Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes	[13] 0
[14] Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit tek trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë	[14] 0
[15] Fitime kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit	[15] 0
[16] Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë tek trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë	[16] 0
[17] Fitime kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë	[17] 0
[18] Të ardhura nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale	[18] 0
[19] Të ardhura nga transaksionet me mjetet virtuale	[19] 0
[20] Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart të realizuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë	[20] 0
[21] Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	[21] 0
[22] Të ardhura bruto të tjera përjashtuara nga tatimi	[22] 0
[23] SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO	[23] 0

Seksioni Të Ardhurat

➤ Rubrika [3] Të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit

Kjo rubrikë shfaqet e parambushur automatikisht e llogaritur nga Totali i Pagës Bruto nga punëdhënsit në secilën listëpagesë mujore_Esig025, në rubrikën [15] Paga Bruto, që i përkasin të njëjtës periudhë kalendarike (janar-dhjetor), për individin (punëmarrës) që ka krijuar dhe po deklaron DVAPv3.

Vlera e kësaj rubrike është e editueshme por pranon vlera më të mëdha se vlera e parambushur.

Shënim: Në rast se kërkohet të ndryshohet me vlerë më të vogël sesa vlera e pagës e parambushur nga listpagesat, sistemi e përditëson atë automatikisht me vlerën e llogaritur sipas rregullit të përshkruar më lart.

TË ARDHURAT E TJERA TË NDRYSHME NGA TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI

Të ardhurat e një individi që kanë karakter të ndryshëm nga punësimi do të deklarohen nga rubrika [4] e ne vijim deri ne rubrikën [22].

Sistemi ka kryer verifikimet dhe ka parambushur automatikisht disa nga rubrikat e DVAP me vlerat e deklaruara për NID, në deklaratat e Tatimit në Burim v3 të deklaruara për individin nga agjentët e tatimit në Burim, për të ardhurat e deklaruara që u përkasin periudhave tatimore mujore janar-dhjetor të vitit kalendarik të njëjtë me atë të deklaratës DVAPv3.

Pavarësisht parambushjes së rubrikave, sistemi lejon ndryshimin e tyre me vlerë më të lartë si dhe njëkohësisht lejon hedhjen e vlerave për rubrikat që nuk janë të parambushura.

Shembull:

- **Rubrika [4] Të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e ngjashme me punësimin por që nuk konsiderohen nga marrëdhëniet e punësimit**

Të ardhurat bruto të ngjashme me të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit plotësohet për shumën e të ardhurave bruto nga honoraret, pjesëmarrje në borde drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjerë, pagesa për performancën e aktorëve, muzikantëve ose sportistëve përfshirë pageast ndaj personave që punësojnë artistë ose sportistë ose veprojnë si ndërmjetës në orgaizimin e shfaqeve apo performancave, pagesa me karakter jo të vazhdueshëm për shërbimet teknike, mësimdhënie, kurse, trajnime.

Në rast se për individin, identifikohen deklarime në deklaratat e Tatimit në Burim v3, që u përkasin periudhave tatimore mujore janar-dhjetor të vitit kalendarik të njëjtë me atë të deklaratës DVAPv3, të deklaruar nga agjentët tatimor në rubrikat e deklaratës TMB:

[14] **Pagesa Honorare** ndaj individëve” (rezidenti/seli e perhershme)

[20] **Pagesa për pjesmarrje në bordet drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjerë**

[24] **Pagesa për performancën e aktoreve, muzikanteve ose sportistëve përfshirë pagesat ndaj personave që punësojnë artiste ose sportiste ose veprojnë si ndërmjetës në organizimin e shfaqjeve apo performancave”** (rezidenti/seli e perhershme)

[28] **Pagesa me karakter jo të vazhdueshëm për shërbimet teknike, mësimdhënie, kurse, trajnime** (rezidenti/seli e perhershme)

[46] **Pagesa Honorare** (jo rezidenti)

[52] **Pagesa për pjesmarrje në bordet drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjerë”** (jorezidenti)

[54] **Pagesa për shërbime teknike** (jo rezidenti)

[60] **Pagesa për performancën e aktoreve, muzikanteve ose sportistëve përfshirë pagesat ndaj personave që punësojnë artiste ose sportiste ose veprojnë si ndërmjetës në organizimin e shfaqjeve apo performancave** (jo rezidenti)

Atehere, sistemi do të parambushë të ardhurën në rubrikën [4], në deklaratën e DVAPv3, të krijuar nga individi.

Në rast se përdoruesi kërkon ta ndryshojë atë dhe e plotëson me vlerë më të vogël se vlera e parambushur, sistemi e përditëson automatikisht me vlerën fillestare të parambushur.

Në rast se për këto rubrika sistemi nuk gjen dhe nuk parambush për NID-in vlera nga TMB, atëherë individi mund të vetëdeklaroj pasi rubrikat lejojnë hedhjen e vlerave më të mëdha se zero (0).

- Rubrikat të cilat do të parambushen automatikisht nga sistemi janë si vijon:

[4]	Të ardhura bruto nga marrdheniet te ngjashme me punesimin
[5]	Të ardhurat bruto nga dividenti
[6]	Të ardhurat bruto nga qiraja
[7]	Kthimi i investimit nga skemat e sigurimit të jetës dhe ose pensionit privat
[11]	Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit
[12]	Të ardhura bruto nga pasuri intelektuale licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike
[13]	Fitime kapitali për kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes
[15]	Fitime kapitali për kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit
[17]	Fitime kapitali nga kalimi i së drejtës së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashgimisë
[20]	Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart të realizuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë

- Rubrikat të cilat nuk kanë parambushje automatike janë si vijon:

[8]	Të ardhurat bruto nga interesat bankare
[9]	Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj
[10]	Fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme
[14]	Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit tek trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë
[16]	Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë tek trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë
[18]	Të ardhura nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale
[19]	Të ardhura nga transaksionet me mjetet virtuale
[21]	Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
[22]	Të ardhura bruto të përjashtuara nga tatimi

Shënim: Per rubrikat e mësipërme të cilat plotësohen automatikisht, mundësohet deklarimi I vlerave më të mëdha se zero në cdo rast që individi I ka përfutur ato përgjatë vitit tatimor për të cilin po kryen deklarimin.

- **Rubrika [23] Shuma e të ardhurave bruto**

Kjo rubrikë është e pa editueshme dhe e llogaritur automatikisht nga sistemi për shumën e të ardhurave në total të deklaruara nga rubrika [3] deri në rubrikën [22].

SHPENZIMET E ZBRITSHME

SHPENZIME TË ZBRITSHME DHE ZBRITJE TË TJERA NGA TË ARDHURAT	
[24] Zbritje nga të ardhurat nga punësimi sipas nenit 22, pika 1, gërmat a, b dhe c	[24] 0
[25] Shumë kompensimi për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç	[25] 0
[26] Shpenzime për arsimin e fëmijëve	[26] 0
[27] Zbritje për kontributin në skemën e pensionit privat nga të ardhurat e punësimit	[27] 0
[28] Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e dividendit	[28] 0
[29] Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat tjera përveç të ardhurave nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit	[29]
[30] SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME DHE ZBRITJEVE TË TJERA	[30]

➤ **Rubrika [24], Zbritje nga të ardhurat nga punësimi**

Shfaqet e llogaritur automatikisht në varësi të vlerës së paraplotësuar në rubrikën [3], të llogaritura sipas tabelës:

Rubrika [3] Të ardhurat bruto (lekë)	Rubrika [24]_Zbritjet personale (lekë)
0-600.000	600.000
600.001-720.000	420.000
>720.000	360.000

Vlera e llogaritur e zbritjes në rubrikën [24] nuk lejohet të jetë më e madhe se vlera e pagës bruto e plotësuar në rubrikën [3].

➤ **Rubrika [24] është e editueshme por lejohen vlera më të vogla se vlera e llogaritur sipas funksionit të mësipërm**, në rast se plotësohet me vlerë më të lartë sistemi e përditëson atë automatikisht me vlerën e llogaritur sipas rregullit të përshkruar më lart.

➤ **Rubrika [25], Shumë kompensimi për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç,**

Llogaritet sipas formulës: Rubrika [18]numri i fëmijëve nën 18 vjeç *48.000 lekë, është e editueshme por nuk lejohen vlera më të mëdha sesa llogaritja automatike dhe se vlera që rezulton në rubrikën [3], të Ardhura nga Punësimi.

➤ **Rubrika [26], Shpenzime për arsimin e fëmijëve në ngarkim të tij,**

Lejohet të plotësohet me vlerë më të madhe se zero por jo më të lartë se 100.000 lekë, vetëm nëse rubrika [3], Të ardhura nga marrdhëniet e punësimit është me e vogël se 1.200.000 lekë.

➤ **Rubrika [27], Zbritje për kontributin në skemën e pensionit privat nga të ardhurat e punësimit**

Sistemi kryen parambushjen bazuar mbi vlerat e deklaruara nga punëdhënësi si zbritje të aplikuar për individin në listpagesë. Kjo vlerë nuk mund të ndryshohet dhe njëkohësisht nuk mund të jetë më e lartë se paga minimale vjetore në lekë.

➤ **Rubrika [28] Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e dividendit**

Vlera e editueshme por me rregullin **jo më e madhe se** paga min*12muaj dhe njëkohësisht jo më e madhe se vlera e totalit të të ardhurave nga dividendi **rubrika [5]**.

➤ **Rubrika [29] Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat tjera përveç të ardhurave nga dividendi**

Vlera e editueshme por me rregullin **jo më e madhe se** paga min*12muaj dhe njëkohësisht jo më e madhe se vlera e totalit të të ardhurave të tjera pa përfshirë të ardhurat nga punësimi , dividendi dhe të ardhurat e pa tatueshme

E rëndësishme: Zbritjet e aplikuar në rubrikat {27,28,29}, përveç rregullit të aplikuar në secilën nga rubrikat gjithashtu në total nuk duhet të kalojnë vlerën e pagës minimale vjetore.

Shembull:

Individi deklaron zbritje për kontribut në skemën e pensioneve private për të ardhura nga dividendi dhe të ardhura të tjera , në nivel maksimal të lejuar për secilën.

SHPENZIME TE ZBRITSHME	
24) Zbritje nga te ardhurat nga punesimi sipas nenit 22, pika 1, gërmat a, b dhe c	360,000
25) Shumë kompensimi për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç	96,000
26) Shpenzime per arsimin e femijeve	
27) Zbritje per kontributin ne skemen e pensionit privat nga te ardhurat e punësimit	0
28) Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e dividendit	480,000
29) Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat tjera përveç të ardhurave nga dividendi	480,000
30) SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME DHE ZBRITJEVE TË TJERA (kutia 24 deri 29)	1,416,000

M.q.s. në total zbritjet e aplikuar në rubrikat { [28] + [29]}, kalojnë vlerën e lejuar të pagës minimale ne nivel vjetor, deklarata nuk mund të dorëzohet dhe sistemi do të shfaq mesazhin paralajmëruar:

[Shkarko udhëzimin](#)

Deklarata Vjetore e Të Ardhurave Personale

Tatimpaguesi Test Periudha: 25-A

Ka gabime validimi.

- Shuma e zbritjeve per kontributin ne skemen e pensionit privat nga te ardhurat e: punësimit (kutia 27), dividendit (kutia 28) dhe te ardhurave te tjera perjashtuar dividendin (kutia 29), duhet te jete jo me e larte se paga minimale vjetore (480000.00) ALL.

SEKSIONI A: TË DHËNA IDENTIFIKUESE

(3/4) REZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË *

TË DHËNA IDENTIFIKUESE MBI INDIVIDIN

(5) Emri Citimi

➤ **Rubrika [30], SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME**

Llogaritet automatikisht dhe përfaqëson totalin e zbritjeve që individi ka aplikuar. Vlera e saj është e paeditueshme dhe ka një rregull validimi sipas të cilit Shpenzimet e llogaritura në total në rubrikën [30], nuk mund të jenë më të mëdha se vlera e te ardhurave pasi te ardhurat e tatueshme nuk mund te llogariten me vlere kreditore.

VLERA E TATUESHME DHE TATIMI PER TU PAGUAR

Rubrikat për të ardhurat e tatueshme dhe tatimin e llogaritur për tu paguar janë të llogaritura automatikisht dhe të paeditueshme.

LLOGARITJA E TATIMIT PËR T'U PAGUAR

[31] Të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit	[31]	0
[32] Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit	[32]	0
[33] Të ardhurat e tatueshme nga dividendi	[33]	0
[34] Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga dividendi	[34]	0
[35] Të ardhura të tatueshme pa të ardhurat nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit	[35]	0
[36] Tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi dhe dividendi	[36]	0
[37] SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR	[37]	

➤ **Rubrika [31]Të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit**

Llogaritet automatikisht për diferencën midis të ardhurave të tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit [3] me zbritjet nga të ardhurat nga punësimi [24];[25];[26] dhe zbritjet për kontributin në skemën e pensioneve private nga punësimi [27].

➤ **Rubrika [32] Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit**

Llogaritet automatikisht bazuar mbi vlerën e rezultuar për të ardhurat e tatueshme me normat :

E ardhura e tatueshme në lekë/vit				Norma tatimore në përqindje
Nga	Deri në			
0	-	2.040.000		13%
2.040.001	Më tepër	0	2.040.000	13%
		2.040.001	Më tepër	+ 23% të shumës mbi 2.040.001

➤ **Rubrika [33] Te ardhurat e tatueshme nga dividenti**

Sistemi kryen llogaritje automatike duke zbritur nga të ardhurat e deklaruara të dividendit në rubrikën [5] me zbritjet e aplikuar në rubrikën [28]. Vlera është e plotësuar automatikisht, e paeditueshme.

➤ **Rubrika [34] Tatimi i llogaritur mbi te ardhurat nga dividenti**

Llogaritet automatikisht bazuar mbi vlerën e rezultuar për të ardhurat e tatueshme të dividendit të rezultuar në rubrikën [33] me normën *8% .

➤ **Rubrika [35] Të ardhura të tatueshme pa të ardhurat nga dividenti dhe marrëdhëniet e punësimit**

Llogaritet automatikisht si totali i të ardhurave përjashtuar të ardhurat nga dividenti dhe punësimi si dhe

të ardhurat e patatueshme duke zbritur gjithashtu vlerën e zbritjes që mund të jetë aplikuar në rubrikën (29) Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat tjera përveç të ardhurave nga dividendi.

➤ **Rubrika [36] Tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga dividendi dhe të ardhurat nga punësimi**

Llogaritet me vlerë automatikisht në bazë të vlerës së rezultuar në rubrikën [35]* normën e tatimit 15%.

➤ **Rubrika [37] SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR**

Përfaqëson vlerën totale të tatimeve dhe Llogaritet si shumë e:

Tatimit të të ardhurave nga punësimi rubrika[32], tatimi i llogaritur i dividendit rubrika[34] dhe tatimi i llogaritur i të ardhurave të tjera rubrika [36].

LLOGARITJA E TATIMIT PËR TU PAGUAR	
(31) Të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit	265,676
(32) Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit	34,538
(33) Të ardhurat e tatueshme nga dividendi	0
(34) Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga dividendi	0
(35) Të ardhura të tatueshme pa të ardhurat nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit	580,000
(36) Tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi dhe dividendi	87,000
(37) SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR	121,538

TATIMET E PAGUARA GJATË PERIUDHËS TATIMORE

Ashtu sikurse për të ardhurat edhe pagesat e deklaruar nga agjenti tatimor për individin, si për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në listpagesat ashtu dhe për tatimin e mbajtur në burim, do të shërbejnë për parambushjen e seksionit tatimet e paguara gjatë periudhës në deklaratën e DVAPv3.

E rëndësishme: Parambushja, përfaqëson vlerën totale për tatimin e të ardhurave nga punësimi të llogaritur dhe deklaruar në listpagesat dhe tatimin e mbajtur në burim të deklaruar në deklaratat e Tatimit në Burim, që u përkasin periudhave tatimore mujore janar-dhjetor të vitit kalendarik për individin, në cdo rast që ka një përputhje të numrit të tij identifikues NID.

Vlera e parambushur për pagesat mund të editohet nga individit gjatë plotësimit të deklaratës por me vlerë më të vogël, nëse vendoset vlerë më e lartë sistemi e përditëson atë automatikisht me vlerën e parambushur.

TATIMI I E PAGUARNA UAJE PERQURUES TATIMOR	
38) Tatimi mbi të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit	0
39) Tatimi mbi të ardhurat e ngjashme me marrëdhëniet e punësimit por që nuk konsiderohen nga marrëdhëniet e punësimit	0
40) Tatimi mbi dividendin	0
41) Tatimi mbi qiranë	0
42) Tatimi mbi fitimet kapitale të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës dhe/ose pensionit privat	0
43) Tatimi mbi interesat bankare	
44) Tatimet mbi fitimet kapitale të krijuara nga investimet në treg	
45) Tatimet mbi fitimet kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronarisë së pasurisë së luajtshme	
46) Tatimi mbi fitimet nga lotaritë apo lojrat e tjera të fatit	0
47) Tatimi mbi të ardhurat bruto nga të ardhurat nga pasuria intelektuale, licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbehen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike	0
48) Tatimi mbi fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes	0
49) Tatimi mbi fitimet kapitale të tatueshme nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit	0
50) Tatimi mbi fitimet kapitale të tatueshme nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë	0
51) Tatimi mbi të ardhurat nga shërbime apo përfilmi i mjeteve virtuale	
52) Tatimi mbi të ardhura nga transakcionet me mjete virtuale	
53) Tatimi mbi të ardhura të tjera të pa përmendura më lart të realizuara brenda territorit të R. Sh.	0
54) Tatimi i logaritit dhe i paguar mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	
55) Kreditori i tatimit të huaj	

Pagesat e kryera për të ardhurat nga punësimi apo tatimin e mbajtur në burim që paraplotësohen nga sistemi në cdo rast që ka të paktën një deklaratë mujore të deklaruar për individin nga agjentët tatimorë janë si vijon:

Rubrika	Emërtimi
[38]	Tatimi mbi të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit
[39]	Tatimi mbi të ardhurat të ngjashme me marrëdhëniet me punësimin
[40]	Tatimi mbi dividendin
[41]	Tatimi mbi qiranë
[42]	Tatimi mbi fitimet kapitale të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës / pensionet private
[46]	Tatimi mbi fitimet nga lotaritë apo lojrat e tjera të fatit
[47]	Tatimi mbi të ardhurat bruto nga të ardhurat nga pasuria intelekt., licenca, te drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që nuk kanë formë fizike
[48]	Tatimi mbi fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nga shitja
[49]	Tatimi mbi fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nga dhurimi
[50]	Tatimi mbi fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nga trashëgimia
[53]	Tatimi mbi të ardhura të tjera pa përmendura më lart të realizuara brenda territorit të R. Sh.

Në rast se individi për rubrikat që parambushen nga listpagesat dhe /ose TMB, nuk ka të dhëna të deklaruara por i vetëdeklaron ato në deklaratën e DVAPv3 (të deklaruara nëpërmjet kësaj deklarate), sistemi nuk do të lejojë hedhje vlerash për pagesa të kryera të tatimeve dhe për rrjedhojë tatimi i logaritit për të do të jetë si rezultat detyrim për pagesë.

****Përjashtimisht për rubrikën [43] Tatimi i paguar për Interesa bankare, lejohet vendosja e vlerës për tatimin e paguar me vlerë më të madhe se zero (0), në rastin kur individi ka deklaruar në rubrikën [8] Të**

ardhurat bruto nga interesat bankare por gjithsesi ato nuk mund të jenë më shumë se 15% e të ardhurave të plotësuara në rubriken [8].

Tatimet e paguara të cilat nuk kanë parambushje për pagesa të kryera do të rezultojnë me zero dhe ato aktualisht në deklaratën e TMB paraqiten si vijon:

[43]	Tatimi mbi interesat bankare
[44]	Tatimet mbi fitimet kapitale të krijuara nga investimet në tituj
[45]	Tatimi mbi fitimet kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësive së pasurisë të luajtshme
[51]	Tatimi mbi të ardhurat nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale
[52]	Tatimi mbi të ardhura nga transaksionet me mjetet virtuale

[54]	Tatimi mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	Lejohet vlera pozitive vetëm nëse të Ardhurat jashtë territorit të R.SH., rubrika [21] ka vlera më të larta se zero.
-------------	---	--

➤ **Rubrika [55] Kreditimi i Tatimit të Huaj**

Kjo rubrikë nuk plotësohet automatikisht nga sistemi por shfaqet e editueshme. Ajo përfaqëson kreditimin e lejuar deri në normën 15% të të ardhurave jashtë territorit të R.SH. të deklaruara nga individit dhe njëkohësisht jo më e lartë se vlera e deklaruar prej tij si tatim i paguar jashtë territorit të RSH.

Shënim: Në skenar kur rubrika [54] Tatimi i paguar jashtë territorit të RSH është i deklaruar me zero, atëherë dhe Kreditimi i këtij tatimi i llogaritur tek rubrika [55]=0.

➤ **Rubrika [56] SHUMA E TATIMIT TË PAGUAR**

Shuma e të gjithave pagesave nga e kutia 38 deri kutia 53 dhe kutia 55, kryhet automatikisht nga sistemi dhe është e pandryshueshme

**Pavarësisht vlerës së deklaruar si tatim të paguar jashtë territorit të RSH kutia [54], kjo pagesë nuk përfshihet në totalin e tatimeve të paguara por shërben si bazë për llogaritjen e kreditimit të tatimit të këtij tatimi sipas rregullave të përshkruar më lart për rubrikën [55].

LLOGARITJA E REZULTATIT

Llogaritja e rezultatit në deklaratën e DVAPv3, kryhet automatikisht bazuar mbi të dhënat që rezultojnë për të ardhurat, zbritjet, detyrimin për tatimin dhe pagesat e kryera gjatë vitit. Individit mund të rezultojë me tatim të mbipaguar ose detyrim për pagesë.

- Në rast se vlera e totalit të tatimeve të paguara është më e lartë se totali i tatimeve të llogaritura { rubrika [56] > rubrika [37]}, atëherë për diferencën e rezultuar, individit i llogaritet vlera e mbipaguar e tatimit në rubrikën [57] të deklaratës.

(56) SHUMA E TATIMIT TË PAGUAR	56,472
(57) TATIMI I MBIPAGUAR	55,500
(58) TATIMI I DETYRUAR PËR T'U PAGUAR	0

- Në rast se vlera e totalit të tatimeve të llogaritura është më e lartë se totali i tatimeve të paguara { rubrika [37] > rubrika [56]}, atëherë për diferencën e rezultuar, individit i llogaritet vlera e tatimit të detyruar për pagesë në rubrikën [58] të deklaratës

(56) SHUMA E TATIMIT TË PAGUAR	56,472
(57) TATIMI I MBIPAGUAR	0
(58) TATIMI I DETYRUAR PËR T'U PAGUAR	95,420

- Në rast se totali i detyrimit të tatimit është i njëjtë me totalin e tatimeve të paguara atëherë rezultati i deklaratës do të jetë i barabartë me zero (0).

(57) TATIMI I MBIPAGUAR	0
(58) TATIMI I DETYRUAR PËR T'U PAGUAR	0

Ruajtja dhe dorëzimi


Pas plotësimit të rubrikave të deklaratës, përdoruesi klikon butonin **Kontrollo saktësinë e formës** për të parë nëse rubrikat përmbushin rregullat e validimit dhe nuk ka gabime në plotësim.

Nëpërmjet klikimit të butonave **Ruaj** **Dorëzo** bëhet ruajtja dhe dorëzimi i deklaratës.

Shënim: Në rast se individit nuk do të vijojë me dorëzimin e deklaratës por do të shtyp butonin **RUAJ**, deklarata vijon të ketë statusin e krijuar por e padorëzuar.

Vlerat e rubrikave që parambushen automatikisht, nuk do të ruajnë ndryshimet që individi mund të ketë kryer. Përgjatë rihapjes së deklaratës, të dhënat do të shfaqen sërish të parambushura me të dhënën më të fundit të ndodhur në databazën e sistemit elektronik tatimor në listpagesat apo deklaratat e TMB.

Në rast se individi vijon me dorëzimin e deklaratës dhe të dhënat e saj plotësojnë kriteret dhe rregullat e përshkruara, atëherë me klikimin e butonit **Dorëzo**, sistemi do të shfaq mesazhin



Deklarata e dorëzuar shfaqet në nën menunë Deklarata të dorëzuara në eFiling dhe ka statusin Gati për procesim.

Deklarata të Dorëzuara

Periudha:

Data e krijimit: -

Ndryshim:

I ndryshuar nga:

Statusi:

[Eksporto në Excel](#) | [Ringarko](#) | Shfaq 10 të dhëna

	Periudha	Data e krijimit	Data e Pritshme e Deklaratës	Data e deklaratës	Data e Plotësimit	Data e Vlerësimit Alternativ	Detyrimi i deklaruar	Kredia tatimore	Modeli i Deklaratës	Statusi i Deklaratës
→	2025 Janar-Dhjetor (25-A)	18.11.2025	31.03.2026	04.12.2025	04.12.2025		0		NORMAL	Deklarata është gati për përpunim
→	2024 Janar-Dhjetor (24-A)	11.03.2025	01.04.2025	12.03.2025	12.03.2025		0		NORMAL	Deklarata e regjistruara.
→	2023 Janar-Dhjetor (23-A)	11.04.2024	30.04.2024	11.04.2024	11.04.2024		21,568		NORMAL	Deklarata e regjistruara.
→	2022 Janar-Dhjetor (22-A)	12.04.2023	02.05.2023	12.04.2023	12.04.2023		24,960		NORMAL	Deklarata e regjistruara.
→	2021 Janar-Dhjetor (21-A)	13.04.2022	04.05.2022	14.04.2022	14.04.2022		17,904		NORMAL	Deklarata e regjistruara.
→	2020 Janar-Dhjetor (20-A)	22.06.2021	30.06.2021	22.06.2021	22.06.2021		9,833		NORMAL	Deklarata e regjistruara.

E para E Mëparshme 1 Pasues E Fundit

Shfaqja e të dhënave nga 1 në 6 nga 6 të dhëna

Një deklaratë e dorëzuar mund të printohet nëpërmjet butonit PRINT, i cili shfaqet në pjesën e poshtme të saj.

(52) Tatimi mbi të ardhura nga transaksionet me mijetë virtuale	<input type="text"/>
(53) Tatimi mbi të ardhura të tjera të pa përmendura më lart të realizuara brenda territorit të R. Sh	<input type="text"/>
(54) Tatimi i llogaritur dhe i paguar mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	<input type="text"/>
(55) Kreditimi i tatimit të huaj	<input type="text"/>
(56) SHUMA E TATIMEVE TË PAGUAR	<input type="text" value="56,472"/>
(57) TATIMI I MËBPAGUAR	<input type="text"/>
(58) TATIMI I DETYRUAR PËR TË PAGUAR	<input type="text"/>


Kthello Prapa

Në rast se individi klikon butonin Printo, atëherë sistemi do të gjenerojë formatin e saj në PDF.

Krijimi i deklaratës model “Ndryshim nga individi”

Pas dorëzimit të deklaratës model Normal, individi mund të kryejë nga eFiling ndryshime të saj brenda 3 muajve nga data e pritshme e dorëzimit.


Një deklaratë e dorëzuar mund të ndryshohet vetëm pasi ajo të jetë me statusin Rregjistruar



	Periudha	Data e krijimit	Data e Pritshme e Deklaratës	Data e deklarates	Data e Procesimit	Data e Vlerësimit Alternativ	Detyrimi i deklaruar	Kq
→	2025 Janar-Dhjetor (25-A)	18.11.2025	31.03.2026	04.12.2025	04.12.2025		0	
→	2024 Janar-Dhjetor (24-A)	11.03.2025	01.04.2025	12.03.2025	12.03.2025		0	
→	2023 Janar-Dhjetor (23-A)	11.04.2024	30.04.2024	11.04.2024	11.04.2024		21,568	
→	2022 Janar-Dhjetor (22-A)	12.04.2023	02.05.2023	12.04.2023	12.04.2023		24,960	
→	2021 Janar-Dhjetor (21-A)	13.04.2022	04.05.2022	14.04.2022	14.04.2022		17,904	
→	2020 Janar-Dhjetor (20-A)	22.06.2021	30.06.2021	22.06.2021	22.06.2021		9,833	

Për individit që kanë dorëzuar Deklaratën Vjetore për të Ardhurat Personale, të modelit “Normal”, mund të regjistrohet deklarata “Ndryshim nga Individi”.

Për të krijuar modelin Ndryshim nga individi ndiqen hapat si më poshtë:

- ❖ Individi klikon mbi menunë Deklarata
- ❖ Individi klikon nën menunë “Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale”
- ❖ Individi klikon mbi nën menunë “Deklarata të Dorëzuara”
- ❖ Individi klikon mbi rekordin e deklaratës Vjetore e të Ardhurave Personale ” e regjistruar
- ❖ Individi klikon butonin 

Automatikisht sistemi krijon modelin Ndryshim nga Individi dhe kjo deklaratë është e vlefshme për editim tek deklarata të padërguara për tu aksesuar më tej nga përdoruesi.


- ❖ Individi plotëson ndryshimet e deklaratës po me të njëjtat rregulla validimi si në deklaratën model "Normal".
- ❖ Individi klikon butonin Dorëzo

Deklarata vjetore e të Ardhurave Personale model “Ndryshim nga Individi”, pasi dorëzohet merr statusin Gati per procesim.Për cdo deklaratë të ndryshuar nga individi, sistemi krijon automatikisht deklaratën e modelit “Shtim”, e cila përmban ndryshimet që janë kryer nga deklarata paraardhese.



Gjenerimi i urdhërpagesës

Për deklaratat e dorëzuara dhe që janë me status “Gati për procesim”, sistemi mundëson gjenerimin e urdhërpagesës bazuar mbi detyrimin e deklaratës, por pa përfshirë të dhënat e ndodhura në kontabilitet të parikonciluara përsa kjo deklaratë nuk ka statusin e kontabilizuar.

Përdoruesi ndjek hapat si mëposhtë për gjenerimin e urdhërpagesës:

- Klikon në menunë Deklarata
- Klikon nën menunë "Tatim mbi të Ardhurat e Korporatës"
- Klikon Deklarata të Dorëzuara
- Klikon shigjetën në rekordin e deklaratës DE-TAK "Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale", me status gati për procesim
- Klikon butonin 

Deklarata të Dorëzuara

Periudha:  

Data e krijimit: -

Ndryshim:

I ndryshuar nga:


Statusi:

Periudha	Data e krijimit	Data e Pritshme e Deklaratës	Data e deklaratës	Data e Plotësisimit	Data e Vlerësisimit Alternativ	Detyrimi i deklaruar	Kredia tatimore	Modeli i Deklaratës	Statusi i Deklaratës
→ 2025 Janar-Dhjetor (25-A)	18.11.2025	31.03.2026	04.12.2025	04.12.2025		0		NORMAL	Deklarata është gati për përpur
→ 2024 Janar-Dhjetor (24-A)	11.03.2025	01.04.2025	12.03.2025	12.03.2025		0		NORMAL	Deklaratat e regjistruara.
→ 2023 Janar-Dhjetor (23-A)	11.04.2024	30.04.2024	11.04.2024	11.04.2024		21,568		NORMAL	Deklaratat e regjistruara.
→ 2022 Janar-Dhjetor (22-A)	12.04.2023	02.05.2023	12.04.2023	12.04.2023		24,960		NORMAL	Deklaratat e regjistruara.
→ 2021 Janar-Dhjetor (21-A)	13.04.2022	04.05.2022	14.04.2022	14.04.2022		17,904		NORMAL	Deklaratat e regjistruara.
→ 2020 Janar-Dhjetor (20-A)	22.06.2021	30.06.2021	22.06.2021	22.06.2021		9,833		NORMAL	Deklaratat e regjistruara.

E para E Mëparshme 1 Pjeses E Fundit Sfaqja e të dhënave nga 1 në 6 nga 6 të dh

Urdhërpagesa gjenerohet dhe printohet me sukses nga përdoruesi në sistem por ajo përmban mesazhin:

Deklarata të Dorëzuara

Periudha:  

Data e krijimit: -

Ndryshim:

I ndryshuar nga:

Statusi:

Info


Urdhër pagesa u krijua me sukses! Shënim: Kjo është një deklaratë urdhër pagese dhe nuk e merr parasysh llogarinë tuaj (debitë dhe kreditë). Për ta përfshirë këtë, Ju lutemi, prisni ditën tjetër dhe do ta gjeni urdhër pagesën tek Kontabiliteti -> Urdhër Pagesa.

Periudha	Data e krijimit	Data e Pritshme	Data e Vlerësisimit Alternativ
→ 2025 Janar-Dhjetor (25-A)	18.11.2025	31.03.2026	

Sistemi mundëson gjenerimin e urdhërpagesës në menunë Kontabilitet / Urdhërpagesat, për detyrimet e papaguara të lidhura me përgjegjësinë tatimore të Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatës, përfshirë dhe gjokat dhe interesat për pagesë të vonuar të kontabilizuara ose të parregjistruara.


Përdoruesi klikon mbi shigjetën → te rekordi që do të përzgjedhë dhe më pas klikon butonin

Printo Urdhërpagesën



Gjenerimi i Urdhërpagesës

Pasi klikon mbi nënmenunë Urdhërpagesat, sistemi të ridrejton në faqen si vijon



Selektohet shigjeta e rekordit për detyrimin që do të paguhet dhe klikohet mbi butonin

Printo Urdhërpagesën

Formati i Urdhërpagesës që gjenerohet nga sistemi, shkakrohet në format PDF dhe përmban elementët e nevojshëm përfshirë dhe gjordat për pagesë të vonuar dhe interes e llogaritura por të parregjistruara në rast se detyrimi principal paguhet në një datë më të madhe se data e pritshme.